



CIMC – 2008/02

Duke marrë parasysh Nenin 3 të Ligjit të KPM-së, përmes së cilit Këshilli vepron duke u bazuar në rekomandimet e Shefit Ekzekutiv dhe Nenin 9.1 i cili autorizon Shefin Ekzekutiv të menaxhojë veprimet ditore me politikat e themeluara nga këshilli:

Duke u bazuar në Nenin 7.7 të Ligjit mbi KPM-në sipas të cilit Këshilli ka përcaktuar Rregullat e tij të Procedurës, dhe Nenin 5 të Rregullave të Procedurës të Këshillit që lejojnë delegimin e përgjegjësisë nga Këshilli te Shefi Ekzekutiv për arsye të zbatimit efikas të rregullave dhe rregulloreve të KPM-së:

Këshilli i KPM-së merr:

VENDIM

Për amandamentimin e vendimit CIMC 2008/02 për delegimin e përgjegjësisë tek Zyra e Shefit Ekzekutiv për të implementuar vendimet e marra nga Këshilli i KPM-së:

1. Shefi Ekzekutiv mund t'u lëshojë urdhra subjekteve transmetuese, të cilat devijojnë nga Termet dhe Kushtet Teknike të licencave të tyre, për të korrigjuar problemet në mënyrë që të vijnë në pajtueshmëri me licencën e tyre. Nëse subjektet transmetuese nuk sillen në pajtueshmëri me këto urdhra, atëherë rasti duhet të paraqitet në Këshill për vendim lidhur me sanksionet, përveç nëse kjo zgjidhet me marrëveshje.
2. Shefi Ekzekutiv mund të kërkojë zgjidhje të rasteve përmes marrëveshjeve me subjektet transmetuese, kur është e mundshme, siç parashihet me Udhëzimin #4 të Udhëzimeve të Këshillit mbi Zbatimin e Sanksioneve ndaj të Licencuarit (CIMC 2006/04).
3. Shefi Ekzekutiv mund të lëshojë vendime lidhur me kërkesat e subjekteve transmetuese për ndryshimin e Pjesës së dytë të Licencës (Termet dhe Kushtet Teknike), në rastet kur ndryshimet e tilla nuk do të ndikojnë në Pjesën e Tretë të Licencës (Formati i Licencuarit i Programit), në Pjesën e Katërt të Licencës (Harta e Licencuarit e Mbulimit) apo në pronësinë siç është përcaktuar në Deklaratën e pronësisë të subjekteve transmetuese. Në raste të tilla, Këshilli veç ka vendosur për zonën e mbulimit-p.sh., shfrytëzimi i hapësirës publike të frekuencës dhe çështjet tjera të pavarura- dhe këto janë thjeshtë teknike që nuk ndikojnë në arsyen themelore në bazë të të cilës Këshilli ka marrë vendimin për licencë. Çdo ndryshim fundamental i një licence i cili mund të ndikojë në vendimin e Këshillit për të dhënat në shfrytëzim spektrin frekuencorë të transmetimit në radhë të parë, siç është zona e mbulimit, pronësia apo skema programore, duhet të paraqitet në

Këshill për vendim në pajtueshmëri me autoritetin ekskluziv të Këshillit sipas Nenit 3.11 të Ligjit të KPM-së.

4. Shefi Ekzekutiv mund të lëshojë Vërejtje me shkrim për çdo subjekt transmetues, operator kabllorë dhe ofrues të shërbimeve programore për çdo shkelje të bërë, dhe kjo vërejtje konsiderohet si masë e fundit para se për një subjekt transmetues, një operator kabllorë apo një ofrues të shërbimeve programore të merret Vendim për ndonjë masë sanksionuese siç është e paraparë me Nenin 20 të Ligjit të KPM-së.
5. Për subjektet transmetuese që asnjëherë nuk janë licencuar Shefi Ekzekutiv mund të lëshojë urdhër që të ndalojnë transmetimin dhe po ashtu mund të lëshojë çfarëdo urdhëri pasues për të konfiskuar pajisjet. Nëse një subjekt transmetues të cilit i është revokuar licenca përmes një vendimi final dhe detyrues vazhdon të transmetojë apo rifillon transmetimin pas revokimit, Zyra e Shefit ekzekutiv duhet të paraqes rastin në Këshill në mënyrë që Këshilli të konfirmojë faktin se subjekti transmetues është duke transmetuar me licencë të revokuar dhe që këshilli të urdhërojë zyrën të merr masat e duhura për konfiskim të pajisjeve.
6. Shefi Ekzekutiv mund të lëshojë urdhër edhe për subjektet e licencuara me qëllim të sjelljes së tyre në pajtueshmëri Ligjin për KPM, Kushtet e Licencës dhe të gjitha aktet nënligjore në fuqi.
7. Shefi Ekzekutiv mund të përgatis draft-përgjigjen ndaj ankesave të subjekteve transmetuese në Bordin e Ankesave për Media kundër Vendimit të Këshillit. Pasi që ankesat janë kundër vendimeve të Këshillit, teknikisht Këshilli duhet të mbrojë vendimin dhe të paraqes përgjigje me shkrim. Kur të miratojë përgjigjen, Këshilli mund t'ia delegojë përfaqësimin Zyrës së Shefit Ekzekutiv apo mund të emërojë një anëtarë të Këshillit të paraqitet para Bordit të Ankesave për Media për të bërë mbrojtjen ndaj Ankesës. Pasi Bordi i Ankesave për Media mund të takohet në mes të seancave të Këshillit, dhe përgjigja ndaj ankesës vetëm pason një vendim veçmë të marrë nga Këshilli, Shefi Ekzekutiv mund të shtyj përpara këtë procedurë përmes konsultimit me kryesinë e këshillit.
8. Në çdo mbledhje të Këshillit, Shefi Ekzekutiv do të paraqet para Këshillit një përmbledhje të çdo rasti që bie në kategoritë më të lartë me të cilat Shefi Ekzekutiv është marr para takimit të mëparshëm të Këshillit.
9. Këshilli do të shqyrtojë delegimin e përgjegjësive të paktën një herë në vit.

Vendosur nga Këshilli i KPM-së në takim të datës 28 gusht 2009


Argjentina Grazhdani
Kryesuese e Këshillit të KPM-së



28.08.2009
Datë